

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje beton i gatshëm

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44114100-3 Beton me përzierje të gatshëm

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,320,900 (tetë milion e treqind e njëzet mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

2. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001-2015 ose ekuivalent** (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët

ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportin e testimin dhe raportin e analizave, të lëshuar nga një laborator i certifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar, për mallin objekt prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/c e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponoj impiant prodhim betoni në pronësi/me qera ose menyra të tjera të disponimit të parashikuara në legjislacionin në fuqi, ose kontratë furnizimi për mallin objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e kontratës. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B) në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme deri në realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të ligjit 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses si dhe të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e legjislacionit mjedisor me qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër në çdo kohë furnizimin e Autoritetit Kontraktor në të gjithë ditët e javës, në vendin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë

disponueshmërinë e tyre për dërgimin e mallit në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës.

- 2.3.5. Një punësim minimalisht prej 5 (pese) **punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
 - Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **muajin** e fundit të deklaruar.

2.3.5/1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi 4 (katër) manovratore me DAP, dhe 1 (një) shofer, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 5, **dhe për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,

Ne rast se makinerite disponohen me qera, drejtuesit e mjeteve mund të disponohen edhe nepermjet kontraktimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autobetoniere me targa	3 copë	Pronësi ose me qera
2	Autopompë betoni me targa	1 copë	Pronësi ose me qera
3	Dumper për transport malli brenda kantierit , me targa	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikatën e kontrollit teknik; c) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: b) leje qarkullimi; a) leje qarkullimi; b) çertifikatën e kontrollit teknik; c) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës,. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për beton C - 20/25 (me çakëll) Beton C - 25/30 (me çakëll) që ka AK, i cili shërben për realizimin e proceseve të punës, konkretisht ndërtimi i shtresave kaluese rrugore prej betoni dhe beton arme në rrugët rurale, për ndërtimin e mureve mbajtëse dhe pritëse, për veshjen e kanaleve vaditëse dhe kulluese si dhe për ndërtimin e mureve të vogla në funksion të mirëmbajtjes së trotuarëve etj, ndërtim kunete. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT